



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Member of International Helsinki Federation for Human Rights*

Tiranë, më 9 Maj 2007

Vendim i nxituar me pasoja të dëmshme

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka ndjekur me vëmendje dhe shqetësim debatin lidhur me urdhërin e KKRT-së për heqjen nga pika e “Taraboshit” të antenave të “Vizion+” dhe “Top Channel” që mundësuam përhapjen e sinjalit të këtyre stacioneve në territorin e Shkodrës.

Ky **vendim drastik dhe i pakonsultuar** paraprakisht justifikohet me nevojën për zbatimin e ligjit, kur dihet se mos-rregullimi i këtij problemi nuk ka ndodhur për fajin e televizioneve ndaj të cilëve aplikohet masa e mësipërme.

KSHH mendon se zvarritjet burokratike dhe mungesa e vullnetit politik janë shkaqet kryesore për mos-amendimin në kohën e duhur të legjislacionit përkatës objekt diskutimi.

Në këtë vështrim, zbatimi formal i ligjit pa marrë parasysh pasojat veç të tjerave, **bie ndesh me parimet kushtetuese dhe qëllimin e ligjit që synojnë garantimin e mediave të lira dhe të drejtën e informimit.**

KSHH vlerëson dhe mbështet reagimin e qytetarëve që nuk pajtohen me një vendim të tillë pikërisht sepse ata privohen padrejtësisht nga informacioni i domosdoshëm që marrin nëpërmjet operatorëve televizivë që siç dihet luajnë një rol të pazëvendësueshëm.

KSHH, **marrjen e kësaj mase nga KKRT e konsideron të nxituar** edhe për faktin se **vetë institucioni ka deklaruar se ky problem do të zgjidhet brenda një kohe relativisht të shkurtër.** Është kjo arsyeja që për KSHH-në është e pakuptimtë përse ky nxitim kaq i madh kur dihet se kjo gjendje është toleruar prej disa vjetësh, gjë që vërtetohet edhe në memorandumun e nënshkruar mes KKRT-së dhe OSBE-së për prodhimin e kartës së frekuencës.

KSHH mendon se KKRT-ja mund të mos kalonte deri në marrjen e masave të tilla, por të jepte licensa rajonale ose kombëtare në përputhje me fushat e lira, që siç thuhet, ekzistojnë në Shqipëri.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Member of International Helsinki Federation for Human Rights*

KSHH shpreh shqetësimin e tij edhe për faktin se **urdhëri i KKRT-së godet fillimisht televizionet më të fuqishme që kanë justifikuar edhe para publikut rolin e tyre informues dhe edukativ**, sikur këto dy televizione të ishin shkelësit më të mëdhenj të ligjit. Për KSHH-në, masa të tilla, krijojnë përshtypjen e **qëndrimeve selektive**, pavarësisht nga deklaratat se ky operacion do të shtrihet edhe ndaj televizioneve të tjera. Për KSHH-në, nëse do të ndodhte kjo, pasojat e dëmshme do të ishin edhe më të rënda. **KSHH mendon se detyra kryesore e KKRT-së është garantimi i mbrojtjes së mediave të lira dhe si pasojë, informimi i pandërprerë dhe objektiv i publikut të gjerë.** Në këtë aspekt, i rëndësishëm është edhe përmirësimi i mëtejshëm i legjislacionit në këtë fushë.

KSHH e shikon të nevojshme t'i sugjerojë KKRT-së të rivlerësojë masat e marra ndaj televizioneve të mësipërme dhe të sigurojë të drejtën e informimit në ato vende ku kjo e drejtë është kufizuar.